



DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E DOGANAVE
Nr. 12021 - Prot.
Datë, më 29.6.2022

1 REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS SHKODËR

Nr. 1011/2 Prot.

Shkodër, më 21.06.2022

LËNDA: Kërkesë për shpallje publike

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI I ANALIZAVE DHE APOSTERIORIT
SEKTORI I MONITORIMIT TË BORXHIT

DREJTORIA E BURIMEVE MBËSHTETËSE ✓

Adresa: Tiranë, Kashar Mëzez, Lagjia Fushë Mëzez, autostrada Tiranë-Durrës, km 1,
Qendra "Pajtoni Bussines Center", kati 5.

Bazuar në nenin 96 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe pikës 4 të nenit 162 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodit të Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë", 4. "...organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe ..." kërkojmë shpalljen publike për;

- **Vendimin Administrativ nr. 29 datë 29.04.2022** për debitorin, "Indrit Avdyl Bysheva", me numër personal identifikimi G71016143P, me adresë: "Perlat Rexhepi" (M.Biçikemi), Nd.008, Ap.142, H.1, Shkodër.
- Për vazhdimin e procedurave ligjore për rikuperimin e borxhit doganor është domosdoshmëri data e shpalljes publike.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin.

KRYETAR

Aida DEZDARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
Dega e Doganës Shkodër

Nr. 525/3 Prot.

Shkodër, më 29.04.2022

V E N D I M
Nr. 29, datë 29.04.2022

Autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër, mori në shqyrtim shkresën nr.22107 prot., datë 10.12.2021 (protokolluar pranë Degës së Doganës Shkodër me nr.2448/4 prot., datë 13.12.2021), të dërguar nga Drejtoria e Hetimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Lënda “Informacion për marrje vendimi...”, Procesverbalin për verifikimin e kontrabandës të mbajtur nga Drejtoria e Hetimit me numër me datë 03.12.2021, si dhe bashkëlidhur dokumentacionin administrativ në lidhje me hetimin administrativ, shkresën nr. 06 prot., datë 05.01.2022 e DDSH, Lënda: “Njoftim procesverbal”; Shkresën nr.06/1 prot., datë 05.01.2022 dërguar Bashkisë Shkodër, Zyrës së Gjendjes Civile; Shkresën Nr. 216/1 prot., datë 12.01.2022, Lënda: “Kthim përgjigje” nga Zyra e Gjendjes Civile Shkodër; Shkresën nr. 06/3 prot., datë 07.02.2021, Lënda: “Njoftim procesverbal”; Shkresën nr. 06/4 prot., datë 21.02.2022 e DDSH Lënda: “Kërkesë për bashkëpunim” drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës, Komisarariatit të Policisë Tropojë; Shkresën nr.525/1 datë 25.02.2022, Lënda: “Kthim përgjigje” nga Komisarati i Policisë Tropojë; Shkresën nr. 525 prot., datë 18.03.2022 e DDSH Lënda: “Kërkesë për bashkëpunim” drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër; Shkresën nr.2511/1 prot., (B.Nd) datë 06.04.2022, Lënda: “Kthim përgjigje” nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër; Shkresë nr.525/2 prot., datë 11.04.2022, Lënda: “Dërgim Dokumentacioni” drejtuar avokate Naxhi Bako me Nr.license 1059.

Dokumentacioni i mësipërm, lidhet me konstatimin e shkeljeve doganore gjatë hetimeve administrative të kryera për shtetasin **z. Indrit Avdyl Bysheva**, i datëlindjes **16.10.1967**, me numër personal identifikimi **G71016143P**, me adresë: “Perlat Rexhepi” (M.Biçikemi), Nd.008, Ap.142, H.1, Shkodër.

Pasi u shqyrtua dokumentacioni i mësipërm rezulton se:

Në kuadër të procedurave hetimore dhe informacionin rezulton se, Dega e Doganës Shkodër me shkresën Nr. 1746 datë 08.06.2017 (nr.14119 datë 12.06.2017) të DPD-së ka dërguar pranë DPD-së, informacion për hetimin dhe verifikimin e tranzitit T1#343 datë 30.05.2017 pasi ka konstatuar pasaktësi dhe ka pasur dyshime të arsyeshme për falsifikim të tij duke konsumuar edhe element të shkeljes administrative të kontrabandës.

Nga këqyrja e dokumentacionit të tranzitit T1#343 datë 30.05.2017, është konstatuar se fatura nr. nr.98544 e blerjes së mjetit ka vlerë më të vogël se vlera reale e mjetit “Mercedez Benz” me numër shasie WDD2210221A181780” (prej 3.000 EUR blerje), e cila mban firmën e shtetasit Hodollari

Me këtë dokumentacion të paraqitur në tranzit është bërë deklarimi me IM4 nr. R 3200 datë 30.05.2017 në zyrën Doganore Shkodër, me po këtë vlerë (3.000 EUR). Shtojmë këtu se nga ana e subjektit në import është paraqitur deklarata e tranzitit nr. 17H080780E008184 datë 29.05.2017 me të cilin ka ardhur mjete nga Kroacia në drejtim të Shqipërisë por pa faturë blerje.

Nga ana e personelit Doganor të Degës së Doganës Shkodër, është bërë ndërhyrja në vlerësimin e mjetit duke mos marrë parasysh faturën e paraqitur bazuar në të dhënat e disponueshme "Quantro Route", ku subjekti ka paguar detyrimin doganor me vlerë 296,174 lekë për mjetin e zhdoganuar.

Me shkresën nr.14119/1 datë 20.06.2017, Drejtoria e Hetimit ka dërguar në Drejtorinë e Informacionit për vërtetësinë e deklaratës së eksportit kroat me EX.A nr. 17H080780E008184 datë 29.05.2017, me destinacion Shqipërinë që i korrespondon IM4 nr. R 3200 datë 30.05.2017 deklaruar për llogari të shtetasit "Indrit Hodollari" me ID G71016143P.

Me shkresën nr.14119/4 datë 03.08.2017, drejtoria e informacionit në DPD, ka dërguar kthimin e përgjigjes të autoriteteve Doganore Kroate e konkretisht dokumentacionin e eksportit nr.17H080780E008184 datë 29.05.2017. Në dokumentacionin e dërguar përveç deklaratës së eksportit nr.17H080780E008184 datë 29.05.2017 e cila është e njëjtë me atë që ka paraqitur subjekti në deklarim, është edhe fatura nr. 98544 e cila ka një vlerë prej 10,000 EUR, pra një diferencë prej 7.000 Eur me faturën e paraqitur në deklarim nga subjekti. (3000 euro).

Nga ana e specialistit të hetimit është kërkuar për të dhënë shpjegime në lidhje me këtë tranzit përfaqësuesit të agjencisë doganore "Ekspres Albania" e konkretisht shtetasit "Ilmir Dani" me ID I60518037T i cili shpjegon se ka pranuar dokumentacionin që i ka dhënë deklaruesi (pronari i mjetit) dhe se ai nuk është në dijeni të dokumentacionit shtesë që ai ka paraqitur në deklarimin e bërë në import në zyrën doganore Shkodër.

Me shkresën Nr.17042 datë 27.09.2021 është bërë njoftimi për paraqitje në Drejtorinë e Hetimit të shtetasit Indrit Hodollari, për të cilën Dega Doganore Shkodër me shkresën nr. 2448/3 datë 20.10.2021 ka kthyer përgjigje se nuk është bërë i mundur njoftimi i tij pasi adresa e dërguar nga hetimi nuk është e saktë.

Nga tërësia e veprimeve, konkludohet se:

Shtetasi Indrit Hodollari me nr ID- G71016143F, ka paraqitur në deklarimin në T1#343 datë 30.05.2017 dokumentacion të falsifikuar e konkretisht faturën e blerjes së makinës me nr. 98544 me vlerë 3,000 EUR e cila pas konfirmimit nga Autoritet Doganore Kroate është në vlerën e 10,000 EUR, kjo me qëllim uljen e vlerës së makinës për të shmangur shumën e detyrimeve doganore që duhen paguar realisht. Për sa më sipër shtetasi Indrit Hodollari duke paraqitur në deklarim një faturë të falsifikuar ka tentuar të zhdoganojë mjetin me një vlerë 3,000 e jo aq sa ka vlerën reale prej 10,000 EUR duke konsumuar elementët e kontrabandës shkelje doganore e parashikuar nga neni 266/1/11 i Kodit Doganor. Në zbatim të neneve 95, 74,a dhe 72 të Kodit Doganor, shtetasi Indrit Hodollari me nr ID-G71016143P duhet të paguante detyrimin doganor në shumën 296,174 lekë, (detyrim i mbajtur shtetasit pas ndërhyrjes së degës së doganës Shkodër). Për shkeljen e konstatuar, bazuar dhe në nenet 268/2 të K. Doganor nga Drejtoria e Hetimit janë plotësuar Proçesverbalet për Verifikimin të Kontrabandës me nr. datë ndaj shtetasit ku u mor masa

penalitetit sa trefishi i detyrimit doganor të shmangur në vlerën 567,000 lekë e cila i duhet mbajtur shtetasit nga autoriteti doganor.

(Detyrimi doganor i llogaritur nga dogana është 296,174 lekë, (mbi reference), për vlerën 10,000 euro. (e paguar). Penaliteti i llogaritur për vlerën 7000 euro, (7000 EURx135-945,000 lekë X 20%-189,000 leke X trefishi =567,000 lekë.)

Në total borxhi doganor i lindur për shtetasit Indrit Hodollari, për D.D.Shkodër është 567,000 Lekë, pasi detyrim doganor i është mbajtur shtetasit nga dogana në deklarim.

Dega e Doganës Shkodër është njohur me dosjen hetimore në datën 13.12.2021 dhe që nga data 05.01.2022 ka bërë disa shkresa për të bërë të mundur njoftimin procesverbalit të konstatimit datë 03.12.2021 ta mbajtur nga OPGj pranë DPD-së, dhe pas disa korrespondencave shkresore, njoftimi i këtij akti është bërë i mundur vetëm me shkresën Nr.525/2 prot., datë 11.04.2022 dërguar përfaqësueses ligjore të z. Hodollari, avokate zj. Naxhi Bako e cila ka marrë njoftim me datë 11.04.2022 dhe nuk ka paraqitur ankim brenda afateve ligjore.

Nga sa më sipër, në përmbledhje të fakteve të dhëna dhe informacionit që disponojmë, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër, gjen të drejtë zbatimin e nenit 736 të VKM-së Nr. 651, datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, të nenit 256, pikës 1 dhe 3; të nenit 276, pikës 1, germës a dhe të nenit 281 të pikës 1, germës b, të Ligjit Nr. 8449/1999 "Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë", i shfuqizuar dhe,

V E N D O S I:

- Shpalljen debitor të shtetasit Indrit Avdyl Bysheva, i datëlindjes 16.10.1967, me numër personal identifikimi G71016143P, me adresë: "Perlat Rexhepi" (M.Biçikemi), Nd.008, Ap.142, H.1, Shkodër. sipas specifikimeve të mëposhtme;
Për, autoveturë e përdorur e markës "Mercedes Benz" S320CDI, VP2007, me naftë, cil 2987 CC, me numër shasie WDD2210221ha181780, te aplikohen sanksionet
Gjobë 3-fish i detyrimit doganor 567,000 lekë
Shuma **567.000 lekë**
(pesëqindegjashtëdhjetëshatatëmijë) lekë
- Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Zyrës së Financës për kontabilizimin e borxhit doganor.
- Një e kopje e këtij vendimi i dërgohet Drejtorisë së Hetimit.
- Bazuar në nenin 281 dhe 282 e Kodit Doganor, kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim tek Drejtori i Përgjithshëm i Doganave brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim.

KRYETARI

Aida DIZDARI